

Mbështetur në rregullorën e punës së Këshillit Akadematik, neni 31 , thërras mbledhjen e tetë të Këshillit të Akadematik dhe propozoj këtë:


#### R E N D I T E

1. Miratimi i Ekstraktit të mbledhjes së shtatë
2. Miratimi i rregullorës për tutor;
3. Marrja e vendit lidhur me mbajtjen e afatit të prillit;
4. Të tjera;

Mbledhja do të mbahet në Akademi në sallën e takimeve më 25.03.2022 (e premte) në ora 10:00.

Kryesues i Këshillit Akadematik

Dr.Sc. Mevlan Bixhau



## E K S T R A K T

Nga mbledhja e Tetë e Këshillit Akademik të mbajtur me datë 25.03.2022, në Akademi duke filluar prej orës 10.00.

Prezentë:

1. Dr.Sc. Mevlan Bixhaku – Kryesues i Këshillit Akademik
2. MSc.Adem Selmani - Koordinator i programit – anëtar
3. Dr.Sc. Eflorim Hajra staf akademik - anëtar
4. MSc. Shpresa Ibrahimimi staf akademik – anëtare
5. Dr.Sc. Astrit Sallauka staf akademik – anëtar
6. Rajmonda Obri - staf administrativ – anëtare
7. Elona Obertinca studente – Përfaqësuese nga Parlamenti Studentor.
8. Fatime Krasniqi - Sekretarja e Përgjithshme e Akademisë - anëtare pa të drejtë vote
9. Dr.Sc. Muhamed Krasniqi Drejtor i akademisë – anëtar pa të drejtë vote
10. Makfire Preniqi - Procesmbajtëse

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Këshillit Akademik Z. Bixhaku duke i falenderuar anëtarët për pjesëmarrje e tyre në takime dhe ju propozoj për miratim këtë rend dite:

## REND DITE

1. Miratimi i Ekstraktit të mbledhjes së shtatë
2. Miratimi i rregullorës për tutor;
3. Marrja e vendit lidhur me mbajtjen e afatit të prillit;
4. Të tjera;

Rendi i ditës i propozuar unanimisht nga anëtarët e Këshillit Akademik.

## **I. Miratimi i Ekstraktit nga mbledhja e shtatë**

Pas miratimit të rendit të ditës nga anëtarët e Këshillit Akademik, Kryesuesi i Këshillit hapi diskutimin lidhur me ekstraktin e mbledhjes së kaluar. Pasi që nuk pati vërjetje Kryesuesi Dr.Sc.Mevlan Bixhaku, propozoj për votim ekstraktin nga mbledhja e shtatë. Proceverbali u miratua njëzëri nga anëtarët e KA-së.

## **II. Miratimi i rregullorës për tutor.**

Kryesuesi Z.Bixhaku, ja kaloi fjalën Sekretarës së Përgjithëshme të Akademisë që t'i njoftoi anëtarët lidhur me përmbajtjen e rregullorës për tutor. Sekretarja para të antëtarëve sqaroi se sipas Statutit të Akademisë roli i tutorit është i parapar të bëhet nga studentët mirëpo ne nuk kemi studentë të vitit të tretë ose dytë që mund të jenë tutor për studentët e vitit të parë, në mënyrë që të rritet kalueshmëria dhe kujdesi ndaj studentëve kemi hartuar një rregullore ku në rolin e tutorit t'i angahojmë mësimdhënësit. Në këtë rregullore shtoj më tutje Sekretarja është përshkruar procesi i tutorimit, përgjegjësit e stafit dhe studentit si dhe në anex të këtij dokumenti kemi hartuar dy formular me të cilët dokumentohet procesi i tutorimit.

Dr.Sc. Astrit Sallauka mori fjalën lidhur me rregulloren, ai tha se ky proces është i mirëseardhur duke parë që pjesëmarrja në ligjerata është shumë e ulët, tutori besoj se do të ngitë pozitivitetin të studentët për të qenë më të përkushtuar për studime.

Pasi që të tjera komente nuk pati lidhur me rregulloren Z.Bixhaku propozoi për votim. Rregullorja për tutorim të studentëve u miratua unanimisht nga anëtarët.

## **III. Marrja e vendimit lidhur me afatin plotësues të prillit**

Kryesuesi i Këshillit Akademik Z.Bixhaku, tha se, edhe pse e dimë që për studentët është i mirëseardhur afati plotësues, bazuar në statutin e Akademisë për afate plotësuese duhet të marrim vendim Këshilli Akademik. Z.Bixhaku hapi diskutimin për të pranishmit, fjalën e mori përfaqësuesja e studentëve Elona Obërtinca. Ajo tha se duke pasqyruar parasysh që shumë nga studentët punojnë, është shumë e rëndësishme që të kemi edhe afatin plotësues prandaj e mirëpresim këtë propozim.

Shpresa Ibrahim, tha se është e rëndësishme të diskutohet edhe sa provime kanë të drejtë t'i nënshtrohen studentët në afate plotësuese, ajo propozoi që të mos ketë kufizime në numër të provimeve. Anëtarët e tjerë të KA-së u pajtuan me propozimin e znj. Ibrahim. Të tjera diskutime nuk pati. Kryesuesi propozoi për votim, Anëtarët votuan njëzëri lidhur me vendimin për afatin e prillit pa kufizime në numër të provimeve.


Të tjera nuk pati në këtë takim.

Mbledhja përfundoi në ora 10:50.

Kryesues i Këshillit Akademik  
Dr.Sc. Mevlan Bixhaku

Procesmbajtësi:  
Zj. Makfire Prenqi

---



---